



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 43

Datë: 12. 12. 2022. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Qemaj Kurtis, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Raportet e Këshillave të KQZ-se

Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës "Punëtorja për shqyrtimin e rregullave zgjedhore, si dhe Hartimi i Planit të Punës së KQZ-se për vitin 2023"

-Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës dhe Vlerësimit të Qendrave të Votimit në Kosovë

-Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës Gjimore dhe Moshës së Liderit të Partive politike: 2017-2021

Këshilli për personel

-Shqyrtimi dhe miratimi i pezullimit të angazhimit të KKZ-ve dhe stafit jopermanente, zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq dhe Zveçan.

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për 'Punetorine per shqyrtimin e rregullave zgjedhore, si dhe Hartimi i Planit te Punes se KQZ-se per vitin 2023''

Rishikimi dhe miratimi i Planit të buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme per Kryetar Komune ne : Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Komunal ne Leposaviq dhe Zveçan.

3. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Čemailj Kurtiš, kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Čemailj Kurtiš: Nëse jeni të gatshëm, mund të filojmë. Përshëndetje për të gjithë. Meqë, kryeari nuk është, unë do ta kryesoj këtë mbledhje, të 43 – me radhë. Në vazhdim, z. Čemailj Kurtiš paraqiti rendin e ditës.

Miratohet rendi i ditës, me 10 vota.

2. Raportet e Këshillave te KQZ-se

Këshilli per Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës "Punëtorja per shqyrtimin e rregullave zgjedhore, si dhe Hartimi i Planit te Punës se KQZ-se per vitin 2023":

Arianit Elshani: Lidhur me raportin e KOZ, sot është shqyrtuar agjenda e takimit: "Punëtorja për shqyrtimin e rregullave zgjedhore, si dhe Hartimi i Planit te Punës se KQZ-se per vitin 2023". Realisht, brenda kësaj punëtorie, shqyrtohet vetëm plani i punës dhe prandaj, duhet të ndryshohet vendimi ! Datat janë: 18-22 dhjetor. Gjatë kësaj kohe, do të ketë raportime nga departamentet, diskutimet dhe ato plane që duhet të barten, përsëriten në vitin e ardhshëm, dhe diskutimet dha analizat në përgjithësi rreth planit. Është ftuar edhe OSBE-ja. Rekomandoj që kjo agjendë të miratohet...

Me 10 vota për, miratohet.

Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës dhe Vlerësim i Qendrave të Votimit në Kosovë:

Arianit Elshani: KOZ ka shqyrtuar edhe analizën dhe vlerësimin të QV-e. Nga kjo analizë, e cila ishte planifikuar të bëhet vetëm nga Koordinimi në Terren, mirëpo më vonë është përfshirë edhe Shërbimi Votues. Analiza, ka kaluar nëpër disa faza, varësisht nga proceset, pjesëmarrësit dhe sipas analizës, është kërkuar që të shtohet numri i QV-e të reja, për shkak të shtimit të banorëve në qendrat urbane, Janë të listuar tani sipas rekomandimeve të ZKZ-ve, dhe ky numër është 29 nga 27 komuna në qendrat urbane, ndërsa në zonat rurale janë 6 kërkesa...

Po ashtu, janë edhe shqyrtuar edhe analizuar krahasimi i të dhënave nga Ekstrakti Civil në relacion me adresat, përputhja e të dhënave me listën votuese, me rrugët në bazë të hartave...

Z. Elshani, shpjegoi më gjerësisht me fakte, shembuj dhe shifra këtë analizë të QV-ve, dhe në fund tha se KOZ e ka vlerësuar shumë lart këtë analizë dhe kërkoi që, KOZ ta miratoj, natyrisht duke kërkuar edhe shfrytëzimin e këtij raporti për nevojat zgjedhore...

Lidhur me raportin, Sami Kurteshi, shtroi pyetje konkrete, kryesisht rreth përmbajtjes rreth shprehjeve të përdorura, formulimit të fjalive, duke dhënë edhe vlerësimet e tij, propozimet etj. Alim Rama, po ashtu, analizoi disa të dhëna, kryesisht rreth adresave të votuesve, qendrave të votimit, njësoj duke e vlerëzuar pozitivisht raportin...

Në fund, analiza u miratua me 9 vota.

Shqyrtimi dhe miratimi i Analizës Gjimore dhe Moshës së Lidershipit të Partive Politike: 2017-2021:

Arianit Elshani: E kemi prezentuar dhe kemi dhënë disa komente, gjatë shqyrtimit. Ka ditë që e keni pasur, dhe se tash, ndryshe nga hera e kaluar, këtë herë mendoj se është një gjithëpërfshirje...

Ilir Gashi, tha se meqë e kemi trajtuar njëherë, njësoj edhe zyra, ndaj mendim pak më ndryshe se kjo analizë nuk e pasqyron gjendjen reale të asnjë subjekti në tërësi...Unë, abstenoj nga raporti...

Ibrahim Selmanaj, dha vërejtjet e tij lidhur me të dhënat, duke konstatuar se realiteti sic cekua ai, për shembull me subjektin që e përfaqëson, AAK, të dhënat nuk janë bash reale...Abstenoj, tha z. Selmanaj...

Sami Kurteshi, tha se meqë raporti bëhet publik, vërejtjet janë të mira, vec le të përfshihen ato...Raporti, ka problem te metodologjia e punës... Për shembull, edhe pse teknike, analiza nuk ka faqe...të paktën tek unë... Ai, bëri vërejtjet e tij, ta zëmë te fq. 8, ku tha se llogaritjet janë bërë të gabueshme, pastaj disa mungesa të paraqitjes së subjekteve ndër vite...etj. Ai bëri vërejtje se, Lëvizja "Vetëvendosje!" nuk është pasqyruar sa duhet, mungon në disa vite analiza për te...

Diskutuan edhe Arianit Elshani, Rifat Krasniq, Alim Rama, Čemailj Kurtiš dhe Sami Kurteshi.

Arianit Elshani, tha që kjo pikë le të tërhiqet. Të përgatitet një dokument, një për nevojat e brendshme dhe një, për publikim...Pra, të kemi edhe dy rekoamdnime: një për vitin 2021, dhe këtë që e kemi...

Besnik Buzhala, si drejtor i ZRPP-së propozoi që kjo analizë të bartet për vitin e ardhshëm, dhe se do të ketë një raport shumë më të mirë, më të detajuar...

Në fund, me 8 vota për dhe 1 kundër, anëtarët e KOZ vendosën që kjo analizë të tërhiqet, dhe të silllet në KOZ pasi që të jetë punuar më mirë, dhe në detaje.

Këshilli per personel:

Shqyrtimi dhe miratimi i pezullimit te angazhimit te KKZ-ve dhe stafit jo permanente, zgjedhjet e jashtëzakonshme per Kryetar Komune ne : Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Komunal ne Leposaviq dhe Zveçan:

Alim Rama, tha se këshilli ka shqyrtuar kërkesën për ndërprerjen e kontratave të stafit jo permanent, veq 6 persona që do të mbeten më tutje si pjesë ndihmëse në Personel dhe Financa. Rekomandimi ynë është që, të ndërptiten të gjitha kontratat, vec këtyre 6 kontratave.

Miratohet ky rekomandim, me 8 vota.

Këshilli per Buxhet dhe Financa:

Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për 'Punetorine per shqyrtimin e rregullave zgjedhore, si dhe Hartimi i Planit te Punes se KQZ-se per vitin 2023'' :

Gordana Llaban: Sot, në takimin e 15 kemi diskutuar dhe shqyrtuar këto dy pika që i kemi në rend dite. Raportin e keni, kurse i gjithë takimi për që do të mbahet prej 18 -22 dhjetor, e ku planifikohet të marrin pjesë 35 persona. Kostoja e punëtorisë, do të jetë 21 165 euro. Rekomandojmë që, të miratohet...

Me 7 vota për, dhe një abstenim (Sami Kurteshi), miratohet ky rekomandim.

Rishikimi dhe miratimi i Planit të buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme per Kryetar Komune ne : Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin Komunal ne Leposaviq dhe Zveçan:

Gordana Llaban: (Nuk ka incizim të mëtutjeshëm...)

3. Të ndryshme !